



Forumi për
Iniciativa Qytetare

RAPORTI VJETOR 2016



Të nderuar miq,

Kosova po përballet me sfida të njëpasnjëshme, politike, ekonomike, mjedisore, arsimore, shëndetësore!

Është e pashmangshme, që ne si individë, apo shoqëri të mos na shqetësojë fakti, që brishtësia e demokracisë sfidohet egërsisht prej korrupsionit, papunësisë, nepotizmit, nivelit arsimor të ulët, dallimeve gjinore, dhe mbi të gjitha prej mungesës së konsensusit politik për modelin e duhur të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit.

Miq,

FIQ punon me të gjitha grupet e shoqërisë (të rinj të shkolluar, ose jo, të punësuar, ose jo, gra, burra në kërkim të një shprese për një jetë më të mirë, komunitete të zhvendosur me dhunë në kërkim të të drejtave të tyre bazike për kompensim, apo zhvendosje të dinjitetshme).

Nëpër komuna ndihet humbja e besimit tek institucionet politikbërëse, ndihet zhgënjimi prej institucioneve ndërkombëtare si të paaftë për të kuptuar kontekstin local, për të koordinuar punën e tyre drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe për të mohuar bashkëpunimin me politikanë të korruptuar. Protestat, peticionet si forma të shprehjes së revoltës shoqërore duket se nuk sjellin rezultat, pasi korrupsioni ka forcuar mburojat rreth pseudoelitave politike duke i bërë përfaqësuesit e tyre gati të paprekshëm dhe imun ndaj ndëshkimit ligjor.

Prona private cenohet në mënyrë të dhunshme dhe asnjë nivel i sistemit gjyqësor nuk ka fuqinë të ndalë apo të sjellë drejtësi për individët e afektuar prej uzurpimeve, apo shpronësimeve të dhunshme.

Pasuritë e përbashkëta degradohen në emër të zhvillimit ekonomik, ligje të prokurimit, apo të investimeve strategjike shkelen. Diskutimi publik i tyre anashkalohet duke krijuar kështu një terr informativ tek qytetarët të cilët në mungesë të perspektivës zgjedhin forma dhe mjete të ndryshme të përballjes me mbijetesën ekonomike.

Në këtë kaos qeverisës dhe mungese vizioni zhvillimor, FIQ i implementon programet e veta në bashkëpunim me partnerët lokalë duke u përpjekur sa më shumë për përfshirje, mobilizim, përfaqësim dhe punë të matshme në terren si strategjia më e mirë për të shkundur sadopak APATINE e qytetarëve.

Filantropia si shprehje e solidaritetit tonë ndaj bashkëqytetarëve tonë na vjen në ndihmë dhe si e tillë jemi të vendosur për ta institucionalizuar rolin e jashtëzakonshëm strategjik të filantropisë në Kosovë.

Miq, shoqëria Kosovare ndodhet në prag të një depresioni i cili duhet parandaluar! Ju ftoj, ti bashkëngjiteni Forumit për Iniciativa Qytetare në punën e tij me qytetarë!

Dajana Berisha
Drejtore e Ekzekutive





Rreth FIQ

Forumi për Iniciativa Qytetare - FIQ është fondacion kombëtar me një traditë të gjatë të punës në komunitet. Themeluar në vitin 2000, FIQ ruajti karakterin e tij si një fondacion tipik komunitar, që në fokus të punës ka qytetarët e Kosovës, mobilizimin dhe fuqizimin e tyre për të kërkuar transparencë dhe llogaridhënie prej institucioneve vendim marrëse.

Nxitja dhe përkrahja e ndërmarësisë në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm, fuqizimi i të rinjve të Kosovës, mobilizimi i qytetarëve dhe përfshirja e tyre në vendimmarrje, zhvillimi i filantropisë komunitare dhe rindërtimi i strukturës shoqërore të komuniteteve janë shtyllat bazë të punës, të cilat formësojnë profilin e organizatës tone. E kur flasim për vizionin e FIQ, deri atëherë kur qytetarët të bëhen hisedarë në zhvillimin e qëndrueshëm të Kosovës, vizioni jonë mbetet "mobilizimi i qytetarëve për tu angazhuar në proceset zhvillimore nëpërmjet aktivizmit qytetarë, ndërmarësisë dhe përfshirjes së drejtpërdrejt në vendim marrje."



atar

Agriculture & Tourism
Accelerator for Youth



"Këto janë raste kur inovacioni është një domosdoshmëri, përfshirja bëhet imperativ i kohës, bashkëpunimi kërkon vizion, këmbëngulje, përkushtim dhe dhembshuri njerëzore për të siguruar hapësirën e nevojshme për zhvillim" - Dajana Berisha

Agon Qorolli- Fermë e kërpudhave

"Kush nuk dorëzohet, nuk humb kurrë. Dashnia për kërpudha ka filluar qysh kur kam qenë i vogël! Luaja lojën Super Mario shumë, kur i haja kërpudhat ishte çasti më i lumtur i lojës e, m'bënin më t'madh! Nuk u dorëzova asnjëherë, tash më nuk kam nevojë t'i kërkoj kërpudhat nëpër ato blloqet me pikëpyetje, ato po rriten vazhdimisht në fermën time. Unë po bëhem më i madh! Krejt kjo e mundshme nga mbështetja prej FIQ, punës, dhe modestisë".

[#nëseunëmundemmundeshedheti](#)



Saranda Musa

Ngritja e serës me perime

"Unë besoj se bujqësia është një nga profesionet më fisnike të njerëzimit. Të punosh tokën, të kultivosh bimët dhe në këtë mënyrë të ushqehesh prej tyre, do të thotë ta duash profesionin që bën".





Ilirdon Rexhepi

Kultivimi i hudhrës dhe qepës

"Për të arritur sukses, qëllimet duhet të jenë më të mëdha se pengesat".



Arbnora Kllokoqi

Kultivimi i mjedrës

"Kur kam dëgjuar për Atar, kam parë se ky projekt është një mundësi e madhe për mua dhe shumë të tjerë. Krijimi i përvojave të reja, dhe mundësia për të zhvillu më tej idetë e mia janë arsyet kryesore pse kam aplikuar për programin".



Projektet fituese janë: Në Prishtinë -Berat Mavriqi - "Jam2016, Emira Polloshka - "Ngritja e Efijencës në Shkollë Fillore", Drilon Hyseni - "Ta ndryshojmë Prishtinën tonë", Liridona Morina - " Prishtina Live Guide".Në Mitrovicë- Besnik Hoti – "Mos rri në këmbë – Ulu, Enis Berisha – Shenjëzimi i zonave të rrezikshme në lumin Ibër dhe Sitnicë, Lindita Hasani – Rregullimi i oborrit të shkollës, Gazmend Ismajli – Parkingu i biçikletave. Në Pejë-Ariston Lipa – "Të ndërtojmë për Kafshët", Fisnik Kurhasani – Mbjellja e pemëve dekorative

Ambasadorët e rinj sjellin projekte konkrete në energjetikë, turizëm, kulturë



Evenimenti është organizuar me pjesëmarrjen e më shumë se 200 të rinjve nga e tërë Kosova, përfaqësuesve të grupeve joformale dhe vullnetarëve të rinj.

Qëllimi i projektit “Ambasadorët e rinj” është nxitja dhe fuqizimi i aktivizimit të të rinjve. Projekti është zbatuar në 4 pilot komuna: Prishtinë, Pejë, Mitrovicë të Jugut dhe Mitrovicë të Veriut, ku 16 ambasadorët e përzgjedhur kanë identifikuar idetë më të mira të prezantuara nga grupet joformale të të rinjve dhe në bashkëpunim me FIQ i kanë përkrahur këta të rinj deri në jetësimin e ideve në projekte konkrete.

Gjatë simpoziumit janë ekspozuar gjashtë prej projekteve të implementuara në fusha të ndryshme si turizmi, kultura, siguria, energjetika.

Jemi shumë krenar që e kemi realizuar këtë projekt, ndërkajq që mbështetja e ofruar është një shtytje e madhe për ne për të vazhduar me projekte të tilla edhe në të ardhmen, - Besnik Hoti, ambasador i ri në Mitrovicë, bartës i projektit “Mos rri në këmbë – Ulu”.

Kemi pasur një interesim të madh të të rinjve për tu kyçur në projekte të ngjashme. Pra mund të shihni se nevojitet vetëm inkurajimi, dëshira dhe përkrahja për të dëgjuar dhe për të inkuadruar të rinjtë, ndërkajq vullneti nuk mungon, - vullnetari i FIQ, Florent Kastrati.

Investimi në rini, vizion për zhvillim të qëndrueshëm

FIQ udhëheq programin e parë për punësim me pronësi vendore

25 të rinj nga mbarë vendi kanë nisur bizneset e tyre në bujqësi dhe turizëm duke ofruar kështu vende pune për dhjetëra të rinj të tjerë, në projektin e parë për punësim të Komisionit Evropian të realizuar plotësisht nga organizatat vendore. Kjo skemë e granteve, e njohur si ATAR, ka prioritet mbështetjen e grupeve më të rrezikuara të të papunëve në Kosovë, dhe është model i bashkëpunimit ndër sektorial, me qëllim të përmirësimit të situatës së punësimit në Kosovë. Mosha e aplikuesve ka variuar prej 16 deri në 29-vjeçar.

Projekti ka pasur si rezultat konkret nxitjen e ndërmarrësisë tek të rinjtë e papunë dhe të rinjtë që janë përfitues nga skema e asistencës sociale. FIQ në bashkëpunim me Fakultetin e Bujqësisë, UP, Agjencinë për Turizëm dhe Komisionin Evropian si dhe Zyrat rajonale të Punësimit, ka bërë identifikimin dhe përgatitjen e të rinjve për tu bërë të pavarur ekonomikisht. Ky projekt 18 mujor ka certifikuar 50 të rinj të pajisur me aftësi për ndërmarrësi në sektorin e bujqësisë dhe eko-turizmit, ndërkaq që 25 bizneset fituese vazhdon t'i mbështes me shërbime të mentorimit dhe krijimit të lidhjeve me bizneset ekzistuese për shkëmbim të produkteve apo përvoja në biznes.

Gjithsej 400 aplikime kanë ardhur nga të rinjtë dhe prej tyre janë përzgjedhur idetë më inovative dhe me potencial qëndrueshmërie në treg.

FIQ në media



Drejtoresha e FIQ flet për programin ATAR.
<https://www.youtube.com/watch?v=KWz7MrWhxn4>

FIQ në media



<https://www.youtube.com/watch?v=rsN2xnMU8lc>



Pasdita në Tribunë - Dajana Berisha, Drejtoresha e Forumit për Iniciativa Qytetare, FIC

Tribuna Channel

YOUTUBE.COM


Në Tribuna Chanel për mbështetjen që po ofron FIQ për zhvillimin e aktivizimit rinor.

FIQ gjithnjë pranë komuniteteve më të rrezikuara

Beteja Ligjore për Haden vazhdon në Uashington

Forumi për Iniciativa Qytetare vazhdon të qëndrojë pranë qytetarëve të Hades duke kërkuar zgjidhjen për kompensim të të gjithë qytetarëve të dëmtuar nga procesi i zhvendosjes së dhunshme. Si rezultat menaxhmenti i Bankës Botërore ka

diskutuar në takimet e rregullta në vjeshtë të gjeturat e panelit inspektues që me ftesën e FIQ ka vizituar Kosovën. Ky panel ka tërhequr vëmendjen e menaxhmentit për shkelje të shumta në procesin e zhvendosjes së banorëve të kësaj zone.



Paneli i Inspektimit i Bankës Botërore ka publikuar raportin ku identifikohen dëme të konsiderueshme dhe të riparueshme të shkaktuara gjatë zhvendosjes për t'i hapur rrugë mihjeve për termocentralin "Kosova e Re." Paneli ka konstatuar se menaxhmenti i BB-së nuk ka vepruar në përputhje me procedurat operative për zhvendosjen e detyruar.



Kosovan villagers to take coal mine woes to ECHR | Climate Home - climate change news

After the World Bank ducks responsibility for harm caused by botched coal...

CLIMATECHANGENEWS.COM | BY KARL MATHIESEN - JOURNALIST

FIQ në media



Mediat botërore raportojnë për problemin e pazgjidhur të banorëve të Hades



Kërkohet seancë për Haden ose do të ketë protesta | | Gazeta e Re

Konsorciumi Kosovar i Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm, ka prezantuar sot gjetjet e raportit Hetues të Panelit të Inspektimit të Bankës...

Foto



Konsorciumi Kosovar i Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm, prezanton gjetjet e raportit Hetues të Panelit të Inspektimit të Bankës Botërore (BB), për zhvendosjen e banorëve të fshatit Hade, banorët i bëjnë thirrje Kuvendit të Kosovës që të mbahet një seancë e jashtëzakonshme, në të kundërtën ata do të fillojnë me protesta. Zhvendosja e banorëve të Hades kishte filluar në vitin 2004 pa respektim të të drejtave të të

zhvendosurve, ndërkohë që kushtet e banimit të ri nuk kanë përmbushur as nevojat themelore infrastrukturore. Zhvendosja është ndërprerë, pak kohë pas fazës së parë, për të lënë 7 mijë banorë pezull.



Foto

Puna me banorët e Hades prezantohet në Forumin e filantropëve në Afrikën e Jugut



FIQ

Forum for Civic Initiatives

Involuntary resettlement making a case for great grass root activism in Kosovo!

FIQ is the first Kosovo community foundation. Since 2000 FIQ has educated, developed and mobilized civic engagement in Kosovo.

The mission of FIQ is to support and empower citizens to take action on issues that affect their community. FIQ is a non-profit organization that is dedicated to promoting civic engagement and social change in Kosovo. FIQ is a registered charity in the UK and a registered company in Kosovo. FIQ is a member of the European Association of Community Foundations (EACF) and the International Association of Community Foundations (IACF).



Photo by FIQ. A group of people, likely students or community members, gathered around a table, possibly participating in a workshop or meeting.

III (Citizenship)

III (Citizenship) is a program that aims to promote civic engagement and social change in Kosovo. It is a registered charity in the UK and a registered company in Kosovo. It is a member of the European Association of Community Foundations (EACF) and the International Association of Community Foundations (IACF).



Photo by FIQ. A group of people, likely students or community members, gathered around a table, possibly participating in a workshop or meeting.

Photo by FIQ. A group of people, likely students or community members, gathered around a table, possibly participating in a workshop or meeting.



Photo by FIQ. A group of people, likely students or community members, gathered around a table, possibly participating in a workshop or meeting.



Photo by FIQ. A group of people, likely students or community members, gathered around a table, possibly participating in a workshop or meeting.



Photo by FIQ. A group of people, likely students or community members, gathered around a table, possibly participating in a workshop or meeting.

Photo by FIQ. A group of people, likely students or community members, gathered around a table, possibly participating in a workshop or meeting.



Photo by FIQ. A group of people, likely students or community members, gathered around a table, possibly participating in a workshop or meeting.

Photo by FIQ. A group of people, likely students or community members, gathered around a table, possibly participating in a workshop or meeting.

Photo by FIQ. A group of people, likely students or community members, gathered around a table, possibly participating in a workshop or meeting.

Photo by FIQ. A group of people, likely students or community members, gathered around a table, possibly participating in a workshop or meeting.

Photo by FIQ. A group of people, likely students or community members, gathered around a table, possibly participating in a workshop or meeting.

Photo by FIQ. A group of people, likely students or community members, gathered around a table, possibly participating in a workshop or meeting.

Photo by FIQ. A group of people, likely students or community members, gathered around a table, possibly participating in a workshop or meeting.

Photo by FIQ. A group of people, likely students or community members, gathered around a table, possibly participating in a workshop or meeting.



World Bank broke own rules as Kosovo coal development left villagers in destitution

The World Bank broke its own rules and contributed to the suffering of hundreds of Kosovars who were forced from their homes to make way for a coal mine, a...

Shkrim në media

Shkrim detaj ne lidhje me shkeljen e rregullave nga vete BB me rastin e trajtimit të zhvendosjes së Hades

As përcaktimi i Komunës së Obiliqit si zonë me interes të veçantë ekonomik sipas Panelit të Inspektimit, nuk është në pajtueshmëri me praktikat ndërkombëtare. Për më tepër, paneli thotë që një proces i tillë i zvarritur i zhvendosjes me vite të tëra dhe ndarja e komunitetit, nuk është në përputhje me standardet ndërkombëtare apo politikat e Bankës Botërore. Banorët bashkë me përfaqësuesit e KOSID, kanë paralajmëruar protesta në rast se kërkesat e tyre nuk merren parasysh. Kërkesat e komunitetit gjithashtu janë duke u hetuar nga Avokati i Popullit i cili po punon për të zbardhur shkeljet e të drejtave të njeriut dhe rreziqet mjedisore me të cilat qytetarët e komunës së Obiliqit po jetojnë. "Ju lirisht mund ta emërtoni këtë vend Çernobili i Ballkanit, në vend se të Obiliq", ka thënë Jashari, duke nënkuptuar problemet mjedisore dhjeta vjeçare që kanë ardhur si pasojë e KEK.

Me iniciativën e FIQ, Komisioni për
Mjedis i Kuvendit të Kosovës ka
vizituar Haden dhe fshatin e ri.



FIQ ka bërë takime me qytetarët dhe me drejtuesit e komunave të cilat ballafaqohen me problemet e rënda të varfërisë dhe mjedisit. Gjatë vitit 2016 janë bërë takime të shumta me qytetarët e Hanit të Elezit, Drenasit, Obiliqit. Këto iniciativa të FIQ kanë për qëllim të ndihmojnë mobilizimin e komunitetit, për të pasur kushte më të mira dhe për t'i realizuar të drejtat dhe kërkesat e tyre.



Banorët kanë theksuar kryesisht problemet e mungesës së zhvillimit ekonomik, punësimit, por në veçanti gjendjes së mjedisit në këto komuna. Përkundër faktit që strategjia makroekonomike e zhvillimit e qeverisë së Kosovës kishte parashikuar që rihapja e gjigantëve si Sharrcem, Ferronikeli, Saloniti do të përmirësonin gjendjen ekonomike ato vetëm se kanë përkeqësuar më shumë gjendjen e banorëve të këtyre zonave, të cilët kanë ndjerë fare pak efektet pozitive të zhvillimit të premtuar. Ndërkaq që ngritja e hidrocentraleve në Deçan, ka rezultuar me shkatërrimin e shtratit të lumit dhe gypave të ujës-jellësit, përdorimin e sasisë së ujit mbi vlerat e lejuara (30% vlera e lejuar), dëmtimin e rrugëve, dhe mos mbajtjen e premtimeve për punësim dhe ndërtim të infrastrukturës, duke i lënë banorët pa ujë të pijshëm. Komuna e Deçanit e ka hedhë edhe në gjyq kompaninë austriake. Përveç hidrocentraleve Ministrisë së Mjedisit nga dora i kanë dalë edhe gurthyesit.

“Gurthyesit kanë shkatërruar tokën e punueshme, malin, si dhe krijojnë zhurmë enorme nga e cila nuk mund të flihet, ndërkohë që Ministria e Mjedisit dhe KPMM po jep leje pa debat publik duke shkelur mbi vullnetin e qytetarëve”, kanë pohuar banorët e Drenasit. FIQ takime me komunitetin po zhvillon në të gjitha komunat në të cilat po rrezikohet mirëqenia e banorëve.

Forumi për Iniciativa Qytetare nderon filantropët më të shquar për vitin 2016



Forumi për Iniciativa Qytetare – FIQ, tanimë ka gjashtë vite, që punon për promovimin e filantropisë për zhvillim të qëndrueshëm nëpërmjet investimeve materiale dhe edukimit të qytetarëve për ngritjen e vetëdijes mbi inkurajimin e një mjedisi mundësues për zhvillimin e filantropisë

Forumi për Iniciativa Qytetare ka organizuar në dhjetor ceremoninë tradicionale FIDES, e cila nëpërmjet

dhënies së çmimeve nderon kontributin filantropik të individëve, organizatave, dhe bizneseve në Kosovë, të cilat kanë mbështetur aktivitete dhe projekte të interesit të përbashkët.

Fituesit e çmimeve ndërkaq janë shprehur se për ta këto mirënjohje krahas njohjes së kontributit paraqesin edhe përkrahje, besim dhe frymëzim për të vazhduar punën e tyre për të mirën e përbashkët.



FIQ nderoi me Çmimin FIDES për Filantropi 2016 për kontribut në nivel kombëtar – “Hasan Prishtina” Girls Coding Kosova

"Falënderojmë FIQ për njohjen e punës tonë. Girls Coding ndihmon rritjen e pjesëmarrjes së vajzave në IT dhe ka aktualisht 700 vajza që punojnë si programere" Blerta Thaqi



FIQ nderoi me Çmimin FIDES për Filantropi 2016 për Kontribute Komunitare: Bonevet

"Ky çmim është shumë i rëndësishëm për ne pasi që njeh punën tonë dy vjeçare për të përmirësuar arsimimin në sektorin e IT në Kosovë dhe për tu mundësuar të rinjve të vendit tonë të bëhen më konkurrues në këtë fushë, të bëhen zot të vetvetes dhe ta ndërtojmë kështu këtë shtet të ri e të bukur që kemi" Leke Zherka

**FIQ nderoi me Çmimin FIDES për
Filantropi 2016 për kontribut
individual aktivisten Marte
Prekpalaj**

"Unë kam marrë shumë çmime ndërkombëtare për punën time, si çmimin e Fondacionit të Paqes në Gjenevë në vitin 2006, por ky është çmimi i parë që me jepet nga njerëzit e mi, vendi im dhe prandaj ka një vend të veçantë në zemrën time", Marte Prekpalaj.



**FIQ nderon me Çmimin FIDES për
Filantropi 2016 për kontribut nga
diaspora Unionin e Bizneseve
Shqiptaro-Gjermane**

"Diaspora luan një rol të rëndësishëm për shumë familje, por në këtë rast angazhimi i diasporës në Kosovë shkon edhe më tej, duke kontribuar në zhvillimin e shoqërisë në tërësi. Rritja e punësimit të grave është e rëndësishme për zhvillimin e vendit në tërësi", Zëvendësambasadorja e Gjermanisë, Christina Gehlsen





FIQ ka ndarë edhe një çmim special për aktorët e rinj Andi Bajgora dhe Lum Veseli

“Kemi realizuar një ëndërr duke arritur majat e industrisë së filmit, Oskar, dhe kjo më bën shumë të lumtur posaçërisht pasi që kështu kemi paraqitur vuajtjet e kombit tonë dhe kemi ndarë historinë tonë me botën” Eshref Durmishi

FIQ prezanton punën në komunitet në
Samitin e Parë Global të Filantropisë Komunitare

Në prag të FIDES 2016
Drejtoresha Ekzekutive e FIQ,
Dajana Berisha ka prezantuar
punën e FIQ në komunitet
gjatë Samitit të Parë Global
të Filantropisë Komunitare,
që sponsorizohet nga Fondi
Global i Fondacioneve
Komunitare dhe Aleanca
Globale për Filantropinë
Komunitare, dhe ka për
qëllim iniciimin e ndryshimeve
që si rezultat do të kenë
vendosjen e avancimit të
kapaciteteve njerëzore në
ballë të punës së
fondacioneve komunitare.

#shiftthepower

Global Summit
on Community
Philanthropy
1-2 December 2016
Johannesburg





Takime me komunitetin për të ngritur kulturën filantropike

Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ) ka organizuar tryezat me temën: "Kontributet filantropike dhe rëndësia e tyre" në Ferizaj, Pejë, Prizren, Mitrovicë, Gjiilan, dhe Gjakovë. Gjatë tryezave është theksuar roli strategjik që ka filantropia në zhvillimin e komunitetit. Qëllimi tryezave ka qenë zhvillimi i kulturës së filantropisë në një mënyrë më të organizuar si dhe angazhimi i komunitetin në njohjen e meritës së atyre që kanë kontribuar deri më sot. Të pranishmit, krahas shumë fushave, si shëndetësia, arsimi, zhvillimi i të rinjve dhe mbështetja e iniciativave në ndërmarrësi, ku kanë kërkuar të ketë më shumë angazhim për ngritjen e kontributeve filantropike, kanë theksuar nevojën që të ngritet më tej kultura e të dhuruarit dhe e njëjta të mirë organizohet në formë ligjore.

Memorandum për zhvillimin e filantropisë



FIQ po angazhohet në përgatitjen e kuadrit ligjor që do të mundësonte që personat që japin kontribute të kenë mbështetje ligjore. Në dhjetor të vitit të kaluar kemi nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit për të bashkëpunuar me Zyrën për Qeverisje të Mirë, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës në hartimin dhe miratimin e koncept dokumentit për filantropi.

Vullnetarizmi forcë dhe vlerë e rinisë kosovare - tregues i angazhimit për të ardhmen



Vullnetarizmi është një nga shtyllat më të rëndësishme të filantropisë bashkëkohore dhe një nga shtytësit kryesorë të ndryshimeve pozitive në komunitet. Në vitin 2016, 15 vullnetar i janë shtuar FIQ duke ndarë kohën e tyre për të ndihmuar FIQ-in gjatë muajit të filantropisë por edhe për të inkurajuar moshatarë e tyre që të kontribuojnë për zhvillimin e vullnetarizmit dhe aktivizmit qytetar. Tanimë sukseset e tyre janë të dukshme me realizimin e filmit të parë për vetëdijesimin për problemet që kanë adoleshentët dhe angazhimin e shoqërisë drejt zgjidhjes së këtyre problemeve si dhe organizimin e Simpoziumit për Ambasadorët e rinj që ka inspiruar shumë të rinj t'i bashkohen iniciativave rinore për një komunitet më të mirë.

Ide të gjelbra dhe inovative

“Ide Biznesi - Të Gjelbërta dhe Inovative 2016 kthehen në storie suksesi”

Fituesit e garës “Ide të Gjelbëra”, për vitin 2016 tashmë kanë filluar të zhvillojnë idetë e tyre. Ndërkaq që fituesi i vitit të kaluar Rron Ceka – i cili pat fituar me idenë “formon” –apo krijimin e printerit inovativ 3D, ku në vend të plastikës klasike të rrezikshme dhe të dëmshme për ambientin, përdorë si lëndë të parë plastikën biodegraduese e fituar nga përzierja e niseshtes së grurit dhe patates, ka fituar edhe çmimin në garën rajonale, me ndihmën financiare të të cilës ai do të mund të zhvillojë edhe më tej idenë e tij.

Ndërkaq fituesit e 2016 janë:

Argjira Krasniqi – “ECOHouse” – Ndërtimi i shtëpive ekologjike duke përdorur metoda moderne dhe resurse natyrale për material ndërtimor, me përdorim të burimeve të energjisë së ripërtërishme dhe dedikuar si zgjidhje më e qëndrueshme dhe afatgjatë për familjet në nevojë.

Luan Hasanaj – “HAMBAR Online” – Hapja e një dyqani online me një gamë të gjerë produktesh ushqimore natyrale dhe organike vendore.

Merita Abdullahu – “Kultivimi Hidroponik i Sallatës së Gjelbërt” – Krijimi i një ferme për kultivimin hidroponik të sallatës së gjelbër, që përveç aspektit inovativ në sistemin e kultivimit, do të ketë ndikim pozitiv edhe në mjedis si pasojë e mos-përdorimit të plehrave dhe pesticideve.



Stafi 2016

Dajana Berisha
Drejtoresh e Ekzekutive

Kushtrim Puka
Menaxher i Programeve

Sefë Govori
Menaxher i Financave

Arieta Dragusha
Zyrtare e Programit

Merita Mustafa
Zhvilluese e programeve

Vatra Qehaja
Zyrtare për Komunikim

Arlinda Azemi
Zyrtare e Programit

Lirika Hoxha
Zyrtare e Financave

Donatorët



Rockefeller
Brother Fund (RBF)



European
Commission



US Embassy
Prishtina



MOTT



Raiffeisen Bank



GIZ



Balkan Trust for
Democracy (BTD)



The National
Endowment for
Democracy (NED)



Saferworld



Caritas



Catalyst

Partnerët



GLPS



BIRN



KOSID



INDEP



Saferworld



Instituti GAP



SIGN Network

Lagjja Pejton
Rr. Sejdi Kryeziu
Blloku 20, Nr. 3
10 000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0) 38 248 677

www.fiq-fci.org



FIQ

Forumi për
Iniciativa Qytetare

www.fiq-fci.org